

SEMINAR PËR ZBATIMIN MË TË GJERË TË NORMËS LETRARE

NË LEZHË

Rrethi shkencor filologjik i arësimitarëve të Lezhës është bërë tashmë një bërthamë e qëndrueshme, rreth së cilës zhvillohet një punë e frutshme dhe me plane perspektive. Arësimitarët e këtij rrethi kanë punuar në fushën e gjuhësisë, të historisë e të etnografisë, duke mbledhur materiale karakteristike për krahinën dhe duke i trajtuar ato në prizmin e detyrave që i dalin shkollës sonë dhe në përgjithësi shkencës e kulturës masive. Dëshmia më e mirë, por jo e vetme e kësaj pune, janë materialet e botuara në almanakun «Lissus».

Për këtë vit rrethi ka përcaktuar si

detyrë kryesore të luftojë për ta shtrirë më gjerë zbatimin e normës letrare në punën me gjuhën në shkollë dhe jashtë saj. Me qëllim që kjo punë të vihet mbi baza shkencore të shëndosha, rrethi e filloi veprimtarinë me një seminar shkencor për problemet e gjuhës letrare, që u mbajt në muajin shkurt. Seminari u organizua në bashkëpunim me Institutin e gjuhësisë e të letërsisë. Merrnin pjesë gjithë mësuesit e gjuhës në shkollat e rrethit dhe punonjës nga degë të tjera, që kanë të bëjnë me çështjet e gjuhës në veprimtarinë e tyre.

Referatin me temë *Të thellojmë zbatimin e normës letrare në shkollë*

dhe në fushat e tjera të punës me gjuhën e mbajti prof. A. Kostallari. Referuesi trajtoi në veçanti çështjet: ç'përfaqëson gjuha letrare në etapën e sotme, cilat janë marrëdhënjet e dialekteve dhe të gjuhës letrare, si ka ecur historikisht formimi i kësaj gjuhe, çfarë prirjesh të mëtejshme të zhvillimit mund të vërehen qysh sot dhe cilat janë rrugët e mjetet për përpjekjet e mëtejshme, që norma letrare të zbatohet sa më gjerësisht.

Në referat u theksua, që kushtet e sotme shoqërore-historike janë mjaft të ndryshme nga ato të paraqirimit. Nëpërmjet një vargu të dhënash statistikore vërtetohet roli i madh që luajnë në jetën e shoqërisë sonë të sotme brezat e rinj, të cilët për këtë arsye janë edhe bartësit e normave letrare të ngulitura e të kristalizuara. Nga kjo pikëpamje çështjet e gjuhës letrare në të gjithë veprimtarinë e shkollës marrin një rëndësi të veçantë, pasi shkolla është përçuesja e vazhdueshme dhe e organizuar e normës letrare.

Në veçanti për gjendjen e sotme të dialekteve dhe bashkëveprimin e tyre me gjuhën letrare foli dialektologu J. Gjinari. Ai tregoi edhe disa tipare dialektore, karakteristike për krahinën e Lezhës, të cilat është e nevojshme të mbahen parasysh për të njohur vështirësitë me të cilat ndeshen nxënësit në shkollë. Në çështjet e normës letrare në fushën e leksikut dhe të formimit të fjalëve u ndal J. Thomaj. Ai paraqiti shtresat e ndryshme të leksikut të shqipes së sotme, duke i vlerësuar nga shkalla e përpunimit me normën e gjallë, vepruese. Ky diferencim i leksikut është i dobishëm sidomos për punën e pasurimit të të folurit të nxënësve me fjalë e shprehje, që i ka ngritur në një shkallë të re gjuha letrare.

Tek problemet e stilistikës në punën me gjuhën në shkollë u përqëndrua Xh. Lloshi. Para së gjithash ai përcaktoi vendin e gjuhës së shkollës në shtresimin stilistik të shqipes së sotme. Gjuha e shkollës në tërësinë e saj hyn në stilin e veprimtarisë shkencore, natyrisht duke patur shkallëzim që nga shkolla

fillore e deri në leksionet universitare. Pa dyshim, veprimtaria e shkollës përfshin edhe mjete nga shtresa të tjera stilistike. Nga pikëpamja e stilistikës, detyrat e mësimit të gjuhës në shkollë na dalin në një aspekt, i cili nuk ka tërhequr sa duhet vëmendjen e mësuesve deri më sot. Shkolla nuk ka si qëllim t'u japë nxënësve vetëm disa njohuri gjuhësore, qoftë edhe për normën letrare. Ajo mëson dhe edukon qytetarët e ardhshëm, të cilët do të punojnë në të gjitha fushat e jetës ekonomike e shoqërore dhe prandaj duhet t'i përgatitë ata, që të marrin pjesë gjallërisht në këto fusha edhe me anë të fjalës së shkruar e të folur. Është fjala për një përvetësim aktiv të mjeteve të gjuhës letrare, duke ua përshtatur detyrave dhe kërkesave të ndryshme, që dalin në fushat e veprimtarisë shoqërore.

Rrethi shkencor në këtë punë ka kapur hallkën më të rëndësishme: kualifikimin e mëtejshëm të mësuesve. Për këtë qëllim në planin që u aprovua nga seminari, u përcaktuan një varg formash të punës. Do të zhvillohen disa seminare të tjera me tema konkrete për punën me gjuhën në shkollë, do të ngrihen kurse të shkurtra, si për shembull për drejtshkrimin, mësuesit do të ndërmarrin studimin e veçorive dialektore të disa zonave në rrethin e Lezhës etj. Jashtë mureve të shkollës rrethi shkencor do të ndihmojë për mënjanimin e të metave gjuhësore në punën e institucioneve të tjera. Gërshetimi i kësaj pune jashtë shkollës në format e ndryshme mësimore-pedagogjike do të ndihmojë që për nxënësit të krijohen kushtet e përshtatshme për një përvetësim e përdorim edhe më aktiv të gjuhës letrare, për një kulturë më të lartë të gjuhës.

Instituti i gjuhësisë e i letërsisë do të japë gjithashtu ndihmë të kualifikuar për të gjithë veprimtarinë.

Veprimtaria e rrethit shkencor të arsimtarëve të Lezhës nuk është diçka e shkëputur nga puna që po bëhet sot në shkollë kombëtare për të ngritur nivelin shkencor të punës së mësuesve, në

veçanti për një cilësi më të lartë të mësimin të gjuhës në shkollë. Në rrethet e Vlorës, të Shkodrës, të Kukësit, të Krujës të Tepalenës e në rrethe të tjera etj. gjithashtu po punohet për thellimin e zbatimit të normës letrare. Kështu tashti lind një detyrë e re: përvoja e

grumbulluar të shkëmbehet midis rrethëve të ndryshme dhe të bëhet një përgjithësim i saj, në mënyrë që t'i shërbejë punës me gjuhën në shkollë në shkallë kombëtare.

XH. LL.

S